



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

NR	15-020-75191
DATË	8.12.2021
PËR	Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit Komunal Lipjan
NGA	Z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit
LËNDA	Kërkesë për procedim për pikë të rendit të mbledhjes në Kuvendit të Komunës



Kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës të parasheh në rend të ditës për shqyrtim – diskutim si vijon:

- Raportin e zbatimit të Planit të Integritetit në Komunën e Lipjanit

Shtojcë: Raportii i zbatimit të Planit të Integritetit në Komunën e Lipjanit



**KOMUNA E LIPJANIT**  
**OPSHTINA LIPLJAN**  
**MUNICIPALITY OF LIPJAN**

**RAPORT**

**ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT**  
**KOMUNA E LIPJANIT**

**Lipjan, 2021**

## **PËRMABJTJA**

<b>HYRJA.....</b>	<b>3</b>
<b>QËLLIMI DHE STRUKTURA E RAPORTIT.....</b>	<b>4</b>
<b>METODOLOGJIA.....</b>	<b>5</b>
<b>MONITORIMI.....</b>	<b>6</b>
<b>PËRSHKRIMI I RAPORTIT TË MONITORIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT.....</b>	<b>7</b>
<b>KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET.....</b>	<b>15</b>

## **HYRJA**

Plani i integritetit është dokument strategjik dhe operativ që ka rezultuar nga procesi i vlerësimit të rrezikut të ndërmarrë brenda komunës së Lipjanit. Plani i integritetit rithekson përkushtimin e komunës për të përmirësuar edhe më tej kontrolllet ekzistuese operative në të gjithë spektron e aktiviteteve të kryera, me fokusim në ofrimin e shërbimeve transparente, efikase dhe që kanë qytetarin në qendër të vëmendjes. Plani i integritetit i përshkruan masat bazuar në rrezik për arritjen e objektivave të veta të integritetit dhe përfshirja e sundimit të ligjit dhe vlerave e standardeve profesionale.

Ky plan do të luajë një rol të rëndësishëm për komunën e Lipjanit në:

-Parashikimin e menaxhimit të rrezikut të integritetit përfshirë komunën, me fokus strategjik në fushat me rrezik të lartë: balancimi i menaxhimit të rrezikut të integritetit pro aktiv me menaxhimin reaktiv: reduktimin dhe eliminimin e mundësive përfshirjeve të korrupsionit dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë së përgjithshme ndaj korrupsionit.

-Forcimin e respektimit të kërkimesave përkatëse ligjore dhe procedurale, si dhe standardeve themelore ndërkombëtare të menaxhimit.

-Zhvillimin e mëtejshmërisë së integritetit, ndërgjegjësimin e tyre, në të gjitha nivelet dhe funksionet, inkurajimin e përkushtimit kolektiv dhe të bashkë-pronësisë në menaxhimin e integritetit.

-Forcimin e mirëbesimit me akterët e jashtëm dhe brendshëm dhe reagimin ndaj kërkimesave dhe pritjeve të tyre përfshirë sa i përket përformancës së integritetit.

Plani ndërtohet mbi bazën e rezultateve të një procesi gjithëpërfshirës të planifikimit të integritetit dhe të vlerësimit të rrezikut, i realizuar në komunën e Lipjanit, që është iniciuar në fillim të vitit 2017. Ky plan konsiderohet të jetë pjesë e rëndësishme e proceseve të përgjithshme të planifikimit komunal, lidhur me planin strategjik përfshirë zhvillim institucional, i cili prekë edhe aspektin e menaxhimit të rrezikut. Në nivel më të gjerë, ai plotëson zbatimin efektiv të Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit, në pjesën që ka të bëjë me qeverisjen lokale.

Me zbatimin e këtij plani të integritetit, komuna është në një pozitë më të mirë në sigurimin e efikasitetit, efektivitetit, transparencës dhe etikës.

## **QËLLIMI DHE STRUKTURA E RAPORTIT**

Ky raport ka për qëllim matjen e zbatueshmërisë së planit të integritetit nga zyrtarët dhe udhëheqësia e komunës së Lipjanit për vitin 2021. Për ta kryer matjen e zbatueshmërisë, rapporti është fokusuar në matjen e faktorëve kryesor të rrezikut që e përbëjnë planin e integritetit.

Faktorët kryesor të rrezikut të planit të integritetit janë ndarë sipas fushave:

### **1. FUNKSIONET E PËRGJITHSHME TË KOMUNËS**

- a) Sistemi i menaxhimit financiar, regjistrimi dhe menaxhimi i aseteve
- b) Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore
- c) Auditimet e brendshme
- d) Prokurimi publik

### **2. ETIKA DHE INTEGRITETI**

- a) Konflikti i interesit
- b) Mospërputhja e funksioneve
- c) Deklarimi i pasurisë
- d) Ndalimi dhe kufizimi i pranimit të dhuratave apo akomodimit
- e) Integriteti dhe transparenca në përgjithësi

### **3. FUNKSIONET E VEQANTA TË KOMUNËS**

- a) Licencimi i shërbimeve dhe objekteve publike
- b) Gjeodezi dhe kadastër
- c) Inspektorati
- d) Arsimi
- e) Shëndetësia dhe mirëqenia sociale
- f) Kultura, rinia dhe sporti
- g) Komunikimi me akterët kryesor të jashtëm

## METODOLOGJIA

Raporti do të fokusohet tek faktorët e rrezikut që janë pjesërisht të zbatueshëm dhe tek ata që nuk janë zbatuar fare. Andaj për hartimin e këtij raporti së pari jemi mbështetur në pyetësorët të cilët janë plotësuar nga zyrtarët e caktuar brenda drejtorive përkatëse lidhur me veprimet konkrete për zbatimin e aktiviteteve për planin e integritetit.

Pastaj :

- Janë nxjerrë faktorët e rrezikut të cilët nuk janë zbatuar ose janë zbatuar pjesërisht. Për identifikimin e faktorëve të rrezikut është marrë përbazë plani i integritetit 2021-2022.

- Në bazë të të dhënave që janë gjetur në planin për integritet, përgjithë faktorët rrezikut pjesërisht të zbatueshëm dhe të pa zbatuar ende, janë krijuar pyetësor dhe janë shpërndarë nëpër drejtori përkatëse. Pas analizimit të përgjigjeve ne kemi krijuar një tabelë dhe kemi identifikuar faktorët e rrezikut të cilët janë pjesë e planit të integritetit dhe të cilët mbetet të plotësohen në vitin në vijim. Pra bazuar në përgjigjet që kemi marrë nga drejtoritë, i kemi paraqitur të dhënat për zbatimin e secilit faktorë të rrezikut të lartpërmendur.

-Në fund janë nxjerrë përfundimet dhe rekomandimet.

## **MONITORIMI**

Monitorimi është proces që përfshinë kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës, për zbatimin e masave të miratuara në planin e integritetit.

Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë efikase, nëse kanë evidentuar ndryshime të vetë rreziqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioriteteve të rreziqeve si edhe nxjerrjen e mësimeve për planifikim më të mirë në të ardhmen. Raportimi është një procedurë e rregullt që siguron zbatimin e planit të integritetit për rreziqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara. Ky proces ndiqet nga personi përgjegjës, i caktuar nga kryetari i komunës, i cili është përgjegjës për raportim. Raportimi lejon kryetarin të ndërmarrë me kohë masa përmirësuese, në rast se zbatimi i ndonjë mase të caktuar ka sjellë vështirësi apo vonesa.

Ky monitorim përfshinë të gjitha fushat që janë pjesë e planit te integritetit duke e analizuar progresin e arritur në të gjitha fushat kryesore të cilat ndikojnë në integritetin e komunës dhe sigurimin e një mjedisi të mirë të kontrollit të brendshëm, duke filluar nga burimet njerëzore, aftësitë dhe kompetencën e tyre, procedurat dhe manualet të cilat përcaktojnë rregullat për sjelljen e të punësuarve në përputhje me kodin e etikës dhe kodin profesional, definimin e kufizimeve për pjesëmarrje në vendime në situata të konfliktit të interesit, transparencën në organizatën buxhetore dhe krijimin e mekanizmave në komunë për identifikimin e mashtrimit.

Prezantimi në mënyrë tabelare i faktorëve të rrezikut të identifikuar, të cilat kanë mbetur pjesërisht apo fare nuk janë mbuluar me aktivitete konkrete.

## PËRSHKRIMI I RAPORTIT TË MONITORIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

Pas përfundimit të punës së monitorimit të planit të integritetit, kemi gjetur se në planin e integritetit ishin gjithsejtë 94 faktorë të rrezikut. Nga analizat e bëra kemi konstatuar se 58 prej tyre ishin zbatuar apo ishin mbuluar me aktivitete të cilat rezultojnë me menaxhimin e tyre, kurse nga pjesa e mbetur prej 36 aktiviteteve, 31 prej tyre ishin mbuluar pjesërisht me aktivitete për zbatim, ndërsa 5 faktorë të rrezikut deri më tani kanë rezultuar se janë pa u mbuluar me aktivitete konkrete për menaxhimin e rrezikut të tyre .

Pjesa tabelare e paraqitur identifikon këto tri kategori :

Faktorët e rrezikut gjithsejtë	Faktorët e rrezikut të zbatueshëm	Faktorët e rrezikut pjesërisht të zbatueshëm	Faktorët e rrezikut të pazbatueshëm
94	58	31	5

Kjo gjendje ka qenë në vitin e kaluar.

Pas kryerjes së monitorimit dhe pranimit të pyetësorëve të plotësuar nga drejtoritë përkatëse, kemi gjetur se ka pasur avancim në zbatimin e aktiviteteve për zbatimin e planit të integritetit, kështu që pas pranimit të pyetësorëve të plotësuar dhe intervistat të cilat i kemi zhvilluar me drejtorët e drejtorive kemi konstatuar si në vijim:

Faktorët e rrezikut gjithsejtë	Faktorët e rrezikut të zbatueshëm	Faktorët e rrezikut pjesërisht të zbatueshëm	Faktorët e rrezikut të pazbatueshëm
94	74	18	2

Në vazhdim do t'i paraqesim në mënyrë të detajuar aktivitetet të cilat në planin e integritetit janë gjetur të plotësuara pjesërisht dhe ato të pa zbatuara, duke i ranguar prej numrit një për secilën fushë ( Drejtori ). Ndërsa faktorët e rrezikut të cilët janë plotësuar janë në planin e integritetit, i cili është aprovuar në vitin 2020, këta faktorë nuk janë paraqitur, pasi që janë të plotësuar.

Fusha e rrezikut	Sistemi i menaxhimit finansiar, regjistrimi dhe menaxhimi i aseteve	Masat ekzistuese/kontrollet e vendosura
------------------	---	---

1.	Mungesë kontrolli për shpenzimet buxhetore.	Të gjitha kontrollet e parapara me rregullën e thesarit 03.2013, të cilat parashihen janë të dizajnuara nga menaxheri i lartë, duke përfshirë të gjithë hapat e procesit të shpenzimit të parasë publike, ( delegimi detyrave te zyrtarët kyç, planifikimi, përgatitja e planit të rrjedhjes së parasë, autorizimet, ekzekutimi, pranimi i mallrave dhe shërbimeve, certifikimi ) etj .
2.	Programi i specifikuar i kontabilitetit nuk është në dispozicion.	Programi i kontabilitetit përdoret për të hyrat që realizon komuna.
3.	Informacionet konfidenciale nuk janë mjaftueshëm të mbrojtura.	Arkivi i shpenzimeve buxhetore ekziston, ruhet dhe mbrohen në bazë të standardeve të këruara.
<b>Fusha e rezikut</b>	<b>Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore</b>	<b>Masat ekzistuese/kontrollet e vendosura</b>

1.	Udhëtimet zyrtare nuk detajohen.	Zyra e burimeve njerëzore mbanë evidencën e udhëtimeve zyrtare sipas ftesës dhe kërkesës së tyre për udhëtimet zyrtare brenda dhe jashtë vendit.
2.	Mungesa e programit të duhur të trajnimit për stafin.	Komuna e Lipjanit e ka të hartuar plan programin për trajnimin e stafit.
<b>Fusha e rezikut</b>	<b>Prokurimi publik</b>	<b>Masat ekzistuese/kontrollet e vendosura</b>
1.	Menaxhimi i dobët financier i projekteve.	Efikasiteti për menaxhimin financier të projekteve është rregulluar me Udhëzimin administrativ 04-2019 dhe 06-2019 të nxjerrë nga Ministria e Financave dhe në bazë të këtij Udhëzimi bëhet menaxhimi financier i secilit projekt.

2.	Menaxhimi jo efikas i projektit.	Menaxhimi i projektit është proces, i cili rrjedh në këtë mënyrë. Menaxheri i projektit ka për detyrë menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit si për punë, furnizime dhe shërbime. Nga menaxheri i projektit, përpilohet <b>Plani i menaxhimit</b> për atë aktivitet të prokurimit dhe si i tillë ngarkohet në platformën elektronike të E-prokurimit. Menaxheri ka edhe mbikëqyrësin për atë projekt, gjë që me këtë rritet efikasiteti i menaxhimit të projektit në fjalë.
3.	Kontrollet joefikase mbi zbatimin e kontratave.	Menaxhimi i kontratave kryhet nga njësia kërkuese, me ç'rast ZKA në bashkëpunim me njësinë kërkuese dhe drejtorinë e prokurimit caktojnë menaxherin për mbikqyrjen e kontratës -për projektet kapitale ZKA emëron komisionin për pranim teknik .
<b>Fusha e rrezikut</b>	<b>Konflikti i interesit</b>	<b>Masat ekzistuese/kontrolllet e vendosura</b>
1.	Nuk ekzistojnë rregullat e brendshme në lidhje me papajtueshmërinë e funksionit.	Në rastet e evidentimit të sjelljeve të cilat nuk janë në pajtim me funksionin që e kryen zyrtari, atëherë këto raste evidentohen nga drejtorët e drejtorive në përputhje me kodin etikës.
2.	Ekziston legjislativi, por punonjësit nuk janë të njohur me të.	Të gjithë zyrtarët janë njoftuar nga zyra e burimeve njerëzore me përgjegjësit e deklarimit të pasurisë dhe dhuratave të pranuara.
3.	Nuk ka aktivitete të ndërgjegjësimit apo trajnime për papajtueshmërinë e funksionit.	Disa nga drejtoritë e komunës sigurojnë trajnime nga Ministritë përkatëse të tyre lidhur me kryerjen e detyrave të zyrtarëve në papajtueshmërinë e funksionit.

<b>Fusha e rrezikut</b>	<b>Mospërputhshmëria e funksioneve</b>	<b>Masat ekzistuese/kontrollet e vendosura</b>
1.	Ekziston legjislacioni, por punonjësit nuk janë të njojur me të.	Ligjërisht secili zyrtar komunal është i obliguar që të njoftohet me ligjet, rregullat dhe procedurat, të cilat janë për pozitën e caktuar.
2.	Nuk ka aktivitete të ndërgjegjësimit apo trajnime për papajtueshmërinë e funksionit.	Pas vlerësimit të punëtorëve në fund të vitit, identifikohen edhe nevojat për trajnim për secilin zyrtar.
<b>Fusha e rrezikut</b>	<b>Deklarimi i pasurisë</b>	<b>Masat ekzistuese/kontrollet e vendosura</b>
1.	Nuk ka aktivitete të ndërgjegjësimit apo trajnime për kërkesat e deklarimit të pasurisë.	Është caktuar zyrtari për njoftimin me kohë lidhur me pranimin dhe deklarimin e pasurisë.
<b>Fusha e rrezikut</b>	<b>Ndalimi dhe kufizimet lidhur me pranimin e dhuratave apo mikpritjes</b>	<b>Masat ekzistuese/kontrollet e vendosura</b>
1.	Nuk ekzistojnë rregulla të brendshme për pranimin e dhuratave.	Pranimi i dhuratave nga zyrtarët e lartë është i rregulluar me ligjin për deklarimin e pasurisë.
2.	Ekziston legjislacioni, por punonjësit nuk janë të njojur me të.	Të gjithë zyrtarët janë të njoftuar nga drejtoret dhe menaxherët, në rastet e pranimit të dhuratave, obligimin e regjistrimit të dhuratave te zyrtari përkatës.
3.	Nuk ekziston zyrtari për mbajtjen e shënimeve të dhuratave.	Ekziston zyrtari kontaktues për pranimin e dhuratave për zyrtarët e lartë publik.
<b>Fusha e rrezikut</b>	<b>Transparenca dhe integriteti në përgjithësi</b>	<b>Masat ekzistuese/kontrollet e vendosura</b>
1.	Nuk ekziston kodi i etikës për anëtarët e Kuvendit Komunal.	Pritet të përpilohet një rregullore – kod etik duke përfshirë parimet kryesore të sjelljes së asamblistëve me kodin etik të Kuvendit.
2.	Mungesa e trajnimeve për etikën, integritetin dhe kodin e mirësjelljes.	Nga DEMOS, NDI dhe USAID janë mbajtur tryeza të rregullta për trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me etikën dhe integritetin e asamblistëve.

<b>Fusha e rrezikut</b>	<b>Inspektimi</b>	<b>Masat ekzistuese/kontrollet e vendosura</b>
1.	Mungesa e trajnimit profesional për inspektorët.	Lidhur me organizimin e trajnimeve, në vitet paraprake janë mbajtur disa në sektorin e sanitarisë, pas të cilit trajnim edhe disa janë certifikuar si inspektorë sanitarë.
2.	Numër i pamjaftueshëm i inspektorëve.	Numri i inspektorëve është zvogëluar me faktin se janë duke u bartur në AVUK –ës.
<b>Fusha e rrezikut</b>	<b>Arsimi</b>	<b>Masat ekzistuese/kontrollet e vendosura</b>
1.	Kurrikula e shkollës nuk është adekuate.	Gjatë 2020/2021 mësimdhënësit kanë vazhduar trajnimet lidhur me zbatimin e kurrikulës për parafillor, klasën e parë, klasën e gjashtë dhe klasën e dhjetë dhe kanë përfunduar trajnimet për të gjitha fushat kurrikulare. Pastaj nga trajneri i fushës dhe koordinatori i kurrikulës në nivel komune është bërë vlerësimi i dosjeve të tyre. MASHT edhe për këtë vit ka paraparë trajnime për zbatimin e kurrikulës për mësimdhënësit që nga muaji Shtator i vitit shkollor 2021/2022. Përveç trajnimeve të organizuara rreth zbatimit të kurrikulës mësimdhënësit do të vazhdojnë edhe trajnime të tjera në mënyrë që të janë në hap me metodologjitë e reja, të cilat përvetësohen përmes trajnimeve të ndryshme.
2.	Planifikimi i shërbimeve arsimore është i pa efektshëm.	Përveç trajnimeve të mësimdhënësve janë bërë edhe hapa në përmirësimin e kushteve në objektet arsimore si dhe kompletimi i kabineteve me mjete pedagogjike

		dhe teknologjike ( furnizimi me kompjutera, llaptopa projektor, furnizimi i bibliotekave me libra )etj.
3..	Mësimdhënësit nuk pensionohen sipas ligjit.	Pensionimi i mësimdhënësve të cilët kanë arritur moshën 65 vjeçare , kryhet nga MAPL në mënyrë të automatizuar.
4.	Çështjet e integritetit nuk janë të përfshira në kurrikulen e arsimit.	Edhe pse nuk janë të përfshira në kurrikulen e arsimit çështjet e integritetit, si drejtori komunale e arsimit përmes zyrtarit pedagog në DKA jemi duke identifikuar nëse ka raste të cilat e cenojnë integritetin e një punëtori arsimor apo nuk ka raste të tilla .
<b>Fusha e rrezikut</b>	<b>Shëndeti dhe mirëgenia sociale</b>	<b>Masat ekzistuese/kontrolllet e vendosura</b>
1.	Infrastruktura joefikase teknike e ofrimit të kujdesit shëndetësor.	Në përmirësimin e infrastrukturës është punuar në renovimin e AMF-Slovi, AMF-Kraishtë dhe AMF-Dobrajë, po ashtu edhe në QKMF-Lipjan, sektorin e stomatologjisë është kryer furnizimi me pajisje mjekësore ( aparat oksigjen-koncentrator, dhe pajisje 32 çanta për mjekë dhe 5 emergjencë për nevoja të KPSH-së), po ashtu rregullimet dhe intervenimet në objektet e QKMF, QMF dhe AMF.
2.	Shpërdorimi i sistemit të informacionit shëndetësor.	Digitalizimi i QKMF-së dhe punkteve është përfunduar, por për shkak të mos funksionalizimit të rrjetit të internetit nuk janë në funksion në punkte (QMF, AMF).
3.	Furnizimi i pamjaftueshëm i barnave.	Komunikimi i rregullt me Ministrinë e Shëndetësisë rreth furnizimit me të mirë me barna nga lista esenciale si

		dhe sigurimi i vaksinave për gripin e zakonshëm dhe virusin Covid -19.
4.	Strategjia për shërbimet e mirëqenies sociale nuk ekziston.	Hartimi i strategjisë për shërbime sociale dhe familjare ka filluar gjatë këtij viti, dhe është në hapat e fundit përfundim të finalizim dhe miratim në Kuvend Komunal.
5.	Sistemi i granteve për shërbimet sociale nuk ekziston.	Gjatë vitit pasues pritet që të ketë bartje të grantit specifik për shërbime sociale dhe familjare, megjithatë shërbimet sociale menaxhohen me ekzekutim finansiarë nga buxheti qeveritar, konkretisht MFPT. Granti i përgjithshëm dhe subvencionet tanimë janë në sistem të shërbimeve sociale në nivelin lokal.
<b>Fusha e rrezikut</b>	<b>Kulturë, Rini dhe Sport</b>	<b>Masat ekzistuese/kontrolllet e vendosura</b>
1.	Mungesa e personelit kompetent për departamentin e kulturës, rinisë dhe sportit.	Stafi në drejtoren e kulturës është i ndarë në tre sektorë:  1.Sektori për sport 2.Sektori për kulturë 3.Sektori i arkivës së qytetit, gjithashu me ndryshimin e statutit të komunës, i cili pritet të aprovohet në Kuvend, pritet të formohet edhe sektori i katërt për rini .
2.	Korniza strategjike për kulturë, rini dhe sport.	Është hartuar Plani i Veprimit Rinor Lokal 2019-2021.
3.	Mungesa e kapaciteteve profesionale e punëdhënësve sportiv.	Janë caktuar detyrat e zyrtarëve në DKRS sipas planit të veprimit rinor lokal.
4.	Numri i pamjaftueshëm i programeve të integritetit, etikës dhe pajtueshmërisë për të rinjtë.	Me rastin e ndarjes së subvencioneve kemi favorizuar organizatat e të rinjve të cilët kanë

		ofruar programe për fushatën ndaj korruptionit .
<b>Fusha e rrezikut</b>	<b>Komunikimi me akterët kryesor të jashtëm</b>	<b>Masat ekzistuese/kontrolllet e vendosura</b>
1.	Arsimimi pamjaftueshëm i qytetarëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.	Të gjithë qytetarët për të drejtat dhe liritë e tyre informohen përmes të gjitha formave publike, si rrjete sociale, ueb faqe, broshura brenda komunës etj.
2.	Bashkëpunimi i pamjaftueshëm institucional kundër korruptionit me komunat e tjera.	Komuna e Lipjanit ka ndërmarrë një sërë veprimesh në parandalimin e korruptionit si: miratimi i Planit Kundër Korruptionit, caktimi i zyrtarit për sinjalizim, hapja e linkut të veçantë në faqen zyrtare të komunës për raportimin e korruptionit, gjithashtu ekziston një komunikim i mirë me zyrtarët e komunave të tjera lidhur me këtë fushë.

## **KONKLUZIONET**

Duke u bazuar në të dhënat që kemi marrë nga drejtoritë e caktuara, mund të përfundohet se ka një progres në relacion me pritshmérinë. Gjithashtu nga raporti i monitorimit ne kemi gjetur se në planin e integriteti ka mbetur edhe një numër i caktuar i faktorëve të rrezikut pa u përmbushur plotësisht sipas afateve, të cilat janë paraparë në planin e veprimit.

Andaj kërkohet që drejtoritë përkatëse t'i caktojnë veprimet e nevojshme për përmbushjen e plotë të këtij plani. Në planin e veprimit ne kemi paraparë edhe fushat kryesore, të cilat kërkojnë një angazhim të të gjitha drejtorive brenda institucionit në mënyrë që të sigurohet një mjedis i shëndosh i kontrollit të brendshëm dhe sigurimin e integritetit në të gjitha segmentet e institucionit –komunës.

## **REKOMANDIMET**

Për të përmirësuar zbatueshmérinë e planit të integritetit, komuna e Lipjanit, respektivisht menaxhmenti i saj duhet të rrisë përkushtimin në secilin departament. Kryetari i komunës duhet të kërkojë nga secila drejtori që të gjejnë formë dhe t'i trajnojnë dhe motivojnë zyrtarët e drejtorisë përkatëse për rritjen e zbatueshmërisë së planit të integritetit. Secila drejtori duhet të raportojë në baza periodike në bordin e drejtorëve për problemet, sfidat dhe avancimet që paraqiten në sektor në lidhje me integritetin komunal.

1. Duhet të planifikohen trajnime dhe tryeza të vazhdueshme me zyrtarët komunal me temën e integritetit dhe të korruptionit në komunë, në mënyrë që zyrtarët të mbahen të informuar me informata të freskëta dhe në kohë reale për situatën e integritetit në komunë.
2. Drejtoritë që kanë ngecur në zbatueshmérinë e planit të integritetit duhet të marrin masa të menjëhershme për përmirësimin e përformancës së tyre.
3. Kuvendi Komunal duhet të hartojë dheaprovojë një kod etik të sjelljes për asamblistët e Kuvendit.